



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2019

## V E N D I M

### Nr. 71, Datë 12/06/2019

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 58, datë 28.05.2019, e Znj. R. B., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”<sup>1</sup>, “*gjendjes arsimore*”<sup>2</sup>, “*gjendjes familjare*” dhe “*përkatësisë në një grup të veçantë*”<sup>3</sup> nga ana e Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

## K O N S T A T O I:

### I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, si dhe referuar dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se Znj. R. B. ka punuar pranë Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) prej datës 07.03.2012, deri në datën 31.12.2017. Fillimisht, ankuesja është emëruar në pozicionin e Drejtores në Drejtorinë e Administratës, nëpërmjet Urdhërit nr. 168, datë 07.03.2012, të Drejtorit Ekzekutiv të kësaj Agjensie dhe në vijim me anë të Urdhërit nr. 70, datë 28.01.2014, të titullarit të institucionit është emëruar në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së IT dhe Marrëdhënieve me Publikun.

---

<sup>1</sup> Referuar Vërtetimit nr. 174/1, datë 06.05.2019, të lëshuar nga subjekti politik LSI.

<sup>2</sup> Referuar Vërtetimit nr. 1171, date 24.04.2017, të lëshuar nga Rektori i Universitetit European të Tiranës.

<sup>3</sup> Referuar Vërtetimit nr. 181, datë 07.02.2014, të lëshuar nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë.

Ankuesja pretendon për diskriminim, për shkaqet e sipërpërmendura, nga ana e Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), lidhur me dy nën-çështje të parashtruara nga ana e saj pranë Komisionerit.

*Nën-çështja e parë*, për të cilën ankuesja pretendon diskriminim për shkak të gjendjes së saj arsimore, konsiston në mos njohjen dhe mos dhënien e shtesës së pagës, nga ana e Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, për efekt të përfitimit nga ana e saj, të titullit “Doktor Shkencash”, pranë Universitetit Europian të Tiranës. Referuar Vërtetimit nr. 1171, datë 24.04.2017, të lëshuar nga UET, Znj. R. B., ka fituar gradën Doktor i Shkencave, pranë Universitetit Europian të Tiranës, në datën 10.02.2017. Ankuesja ka depozituar në datën 15.03.2017, kërkesën me shkrim për njohjen e shtesës në pagë për efekt të fitimit të titullit të sipërpërmendur, në referencë të parashikimeve të akteve përkatëse nënligjore<sup>4</sup>. Në përgjigje të kërkesës së saj, ankueses i është dërguar shkresa nr. 918, datë 08.06.2017, e Drejtorit të Administratës së AKBN-së, nëpërmjet së cilës ajo bëhet me dije se për të përfituar shtesën në pagë, mbështetur në interpretimin ligjor të Drejtorisë Juridike të institucionit, rezulton se duhet marrë miratimi i Këshillit Drejtues dhe i Ministrit të Energjisë dhe Industrisë. Znj. R. B. ka vazhduar me kërkesat e saj për përfitim të shtesës në pagë dhe përgjigja e fundit e ardhur në adresë të saj ka qenë shkresa nr. 918/2, datë 21.12.2017, e Drejtorit Ekzekutiv të AKBN-së, nëpërmjet së cilës, Znj. R. B. bëhet me dije së kërkesa e saj nuk ka qenë pjesë e axhendës për shqyrtim në Këshillin Drejtues të Agjensisë.

Për sa më sipër, ankuesja ka paditur Agjensinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Znj. R. B. është shprehur se gjykata ka dhënë vendim në favor të ankueses.<sup>5</sup>

Për sa më sipër, ankuesja pretendon se për dy punonjës të tjerë të AKBN-së nuk është zbatuar një procedurë e tillë, por shtesa në pagë për efekt të titullit shkencor të fituar, është kryer me urdhër të Ministrit përgjegjës. Ajo pretendon se ndaj saj është vendosur një procedurë që nuk është zbatuar më parë, duke kërkuar paraprakisht miratim të Këshillit Drejtues të Agjensisë, duke e diskriminuar për shkak të gjendjes së saj arsimore.

---

<sup>4</sup> Për shkak të mënyrës së funksionimit dhe organizimit të veçantë, AKBN, duke mos qenë institucion që financohet nga buxheti i shtetit, nuk është i përfshirë në Vendimin nr. 187, datë 08.03.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, por organizimi dhe funksionimi i kësaj Agjensie mbështetet në VKM nr. 547/2006 (i ndryshuar) dhe në Statutin e Brendshëm të kësaj agjensie.

<sup>5</sup> Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë nuk është depozituar në cilësinë e provës pranë KMD-së.

*Nën-çështja e dytë* e parashtruar nga ankuesja, konsiston në largimin e saj nga puna, për shkak të ristrukturimit të institucionit. Me shkresën nr. 1616, datë 20.09.2017, të Drejtorit Ekzekutiv të Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Znj. R. B. është njoftuar për të diskutuar mbi marrëdhëniet e punës, në një takim, i cili u zhvillua në datën 26.09.2017. Referuar shkresës në fjalë rezultoi se si rezultat i ristrukturimit të institucionit, pozicioni i saj i punës është suprimuar. Pas zhvillimit të takimit të mësipërm, është miratuar Urdhëri nr. 1803, datë 29.09.2017, i Drejtorit Ekzekutiv të AKBN-së, “*Për zgjidhjen e kontratës së punës me Agjensinë Kombëtare të Burimeve Natyrore*”, nëpërmjet së cilit është vendosur ndërprerja e marrëdhënieve të punës me Znj. R. B., në datën **31.12.2017**, si pasojë e ristrukturimit të organikës.

Në vijim, ankuesja ka depozituar padi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nëpërmjet së cilës ka kërkuar prej Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, në cilësinë e palës së paditur, detyrimin e saj për të paguar dëshpërblim në masën 12 paga mujore si pasojë e zgjidhjes së kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme etj. Me Vendimin Nr. 0126-18 Regj., datë 28.12.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e pjesëshëm të padisë së ankueses, duke vendosur dhënien e dëshpërblimit në masë më të reduktuar, sesa është kërkuar nga Znj. R. B..

Për sa më sipër, ankuesja pretendon se duke e larguar nga puna, ajo është diskriminuar për shkak të “*bindjes politike*”, pasi ajo është anëtare e subjektit politik “Lëvizja Socialiste për Integrim”. Ajo pretendon diskriminim edhe për shkak të “*përkatësisë në një grup të veçantë*”, pasi Znj. R. B. ka qenë kryetare e Sindikatës së punonjësve të AKBN-së, dhe si e tillë nuk duhej larguar nga puna, pa marrë paraprakisht pëlqimin e sindikatës përkatëse.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin paraprak të ankesës nga Komisioneri.**

- A.** Për efekt të administrimit të informacionit të mëtejshëm, në lidhje me ankesën nr. 58, datë 28.05.2019, e Znj. R. B., Komisioneri i dërgoi ankueses njoftim për paraqitje në takim<sup>6</sup>, i cili u zhvillua në datën 30.05.2019.

Në këtë takim, ankuesja u pyet specifikisht, në lidhje me momentin e ndodhjes së diskriminimit dhe momentin e marrjes dijeni, në lidhje me diskriminimin e ndodhur, për të dyja nën-çështjet e parashtruara nga ana e saj. Në formularin e ankesës, Znj. R. B. ka shënuar datën 31.12.2017, si moment të ndodhjes së diskriminimit, ndërkohë që në Rubrikën ku kërkohet informacion mbi momentin e marrjes dijeni nga ana e ankuesit mbi diskriminimin e pretenduar, Znj. R. B. ka shënuar se ka marrë dijeni mbi ekzistencën e institucionit të KMD-së në mars 2019, fakt që nuk

---

<sup>6</sup> Njoftimi u krye nëpërmjet postës elektronike, në datën 29.05.2019.

përkon me informacionin e kërkuar në formular. Njëkohësisht, në kushtet kur ankuesja pretendon diskriminim për dy nën-çështje të parashtruara nga ana e saj, momentet e ndodhjes së diskriminimit dhe marrjes dijeni mbi këtë diskriminim, për secilën prej tyre, janë të ndryshme.

E pyetur për momentin e parë të diskriminimit të pretenduar, që ka lidhje me shkakun “*gjendja arsimore*”, Znj. R. B. u shpreh se diskriminimi ka ndodhur në datën **08.06.2017**<sup>7</sup> dhe se ajo ka marrë dijeni për këtë diskriminim në **muajin mars 2019**.

Në lidhje me momentin e dytë të diskriminimit të pretenduar, që ka lidhje me “*bindjen politike*” dhe “*përkatësinë në një grup të veçantë*”, Znj. R. B. u shpreh se diskriminimi ka ndodhur në datën **31.12.2017** dhe se ajo ka marrë dijeni mbi këtë diskriminim në **mars 2019**.

Lidhur me shkakun “*gjendja familjare*”, të cilin ankuesja e ka shënuar në formularin e ankesës si një ndër shkaqet e diskriminimit, në takimin e datës 30.05.2019, ajo deklaroi se e tërhiqte si shkak diskriminimi.

Referuar procesverbalit të takimit të datës 30.05.2019, Znj. R. B. iu kërkuar informacion i mëtejshëm që kishte në lidhje në tërësi me ankesën e saj, me pretendimet e saj për diskriminim, të cilat janë reflektuar më lart.

#### **B. Konstatimet e Komisionerit pas analizimit paraprak të ankesës nr. 58, datë 28.05.2019, së Znj. R. B..**

Pas kryerjes së analizimit paraprak të ankesës nr. 58, datë 28.05.2019, së Znj. R. B., Komisioneri konstatoi se:

Në ankesën nr. 58, datë 28.05.2019, e Znj. R. B., pretendohet diskriminim për shkak të “*gjendjes arsimore*”, si pasojë e mos njohjes dhe mos dhënies së shtesës së pagës për fitim titulli shkencor dhe diskriminim për shkak të “*bindjes politike*” dhe “*përkatësisë në një grup të veçantë*”, si pasojë e largimit të saj nga puna, në kuadër të ristrukturimit të Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore.

Lidhur me momentin e parë të diskriminimit të pretenduar, Znj. R. B. ka përcaktuar se diskriminimi ka ndodhur në datën **08.06.2017** dhe se ajo ka marrë dijeni për këtë diskriminim në **muajin mars 2019**. Ndërkohë që, në lidhje me momentin e dytë të diskriminimit të pretenduar

---

<sup>7</sup> Referuar shkresës nr. 918, datë 08.06.2017, të Drejtorit të Administratës së AKBN-së.

nga ana e saj, ankuesja ka përcaktuar se diskriminimi ka ndodhur në datën **31.12.2017** dhe se ajo ka marrë dijeni mbi këtë diskriminim **në muajin mars 2019**.

Të dy momentet e sipërcituara, për të cilat ankuesja pretendon diskriminim, lidhen me veprime konkrete të ndërmarra nga AKBN-në, që janë të reflektuar qartësisht në shkresa zyrtare të lëshuara nga ky institucion, përkatësisht në shkresën nr. 918, datë **08.06.2017**, të Drejtorit të Administratës së AKBN-së dhe Urdhërin nr. 1803, datë 29.09.2017, e Drejtorit Ekzekutiv të AKBN-së, “Për zgjidhjen e kontratës së punës me Agjensinë Kombëtare të Burimeve Natyrore”, nëpërmjet së cilit është vendosur ndërprerja e marrëdhënieve të punës me Znj. R. B., në datën **31.12.2017**.

Në rastin konkret, Komisioneri gjykon se momenti i ndodhjes së diskriminimit të pretenduar, për të dyja nën-çështjet e parashtuara nga ankuesja, është i njëjtë me atë të marrjes dijeni nga Znj. R. B.. Një gjykim i tillë mbështetet në faktin se ankuesja nuk ka dhënë asnjë sqarim apo nuk ka paraqitur asnjë fakt konkret, për të provuar para KMD-së, se për cilat arsye momenti i marrjes dijeni për të dy nën-çështjet e parashtuara nga ana e saj, ka qenë muaji mars 2019, në kushtet kur, ajo ka marrë dijeni mbi përmbajtjen e shkresave të sipërpërmendura në datat respektive.

Në nenin 33, pika 4, gërma dh), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikohet se ankesa nuk pranohet, nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja dijeni nga i dëmtuari, për këtë fakt.

Në këtë kontekst, rezulton se ankuesja ka marrë dijeni mbi diskriminimin e pretenduar, për të dy nën-çështjet e parashtuara nga ana e saj, përkatësisht në datat **08.06.2017** dhe **31.12.2017**, ndërkohë që ankesa e saj është depozituar pranë KMD-së, në datën **28.05.2019**, pra më vonë se 1 vit nga marrja dijeni mbi diskriminimin e pretenduar nga ana e saj.

Në këto kushte Komisioneri gjykon se ankesa e Znj. R. B. është depozituar tej afateve ligjore të përcaktuara nga nenin 33, pika 4, gërma dh), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe ndodhet në pamundësi për të shqyrtuar ankesën nr. 58, datë 28.05.2019, e Znj. R. B..

Për sa më sipër, Komisioneri rekomandon që, ankuesja R. B. të dërgojë për shqyrtim pranë gjykatës kompetente, çështjen për konstatim diskriminimi, pasi ndodhet brenda afateve ligjore të parashikuara nga neni 36, pika 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga

diskriminimi”<sup>8</sup>.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 7, 12, 13, 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma dh), si dhe në nenin 36, pika 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës nr. 58, datë 28.05.2019, së Znj. R. B., pasi ankesa e saj është depozituar tej afateve ligjore, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Robert GAJDA**

---

**KOMISIONERI**

Fusha –punësim  
Shkak – bindja politike

---

<sup>8</sup> Neni 36, pika 1, e ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikon: “*Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita që ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo mëvonë se 3 vjet nga dita që i dëmtuari merr dijeni për këtë sjellje.*”